

KËRKESË
Nr. 5418/5, datë 10.4.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim blloqe banimi rruga ‘Shaban Bushati’”, në Bashkinë Shkodër.

Subjekti kërkuar është Bashkia Shkodër. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari do të likuidohet për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. **Vlera totale e shpronësimit është 4.255.500 (katër milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesë qind) lekë.**

ZËVENDËSMINISTËR
I BRENDSHËM
Romina Kuko

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR OBJEKTIN
“RIKONSTRUKSION RRUGA ‘SHABAN BUSHATI’”, BASHKIA SHKODËR

Nr.	Emër, mbiemër (pronari që shpronësohet)	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Vol.	Faqe	Sip. totale m ²	Nga kjo sip. lekë/m ²	Çmimi trealit lekë/m ²	Vlera e trealit Lekë	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Artan Ferit Salih	8591	4/1072	56	36	500	500	8,511	4,255,500	Konfirmim nga ZVRPP-ja
								Vlera totale	4,255,500	